



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 24, datë 06.03.2024

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR “SOT PËR TË ARDHMEN”, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 169.5 M², KU SIPËRFAQE NDËRTIMI 155 M² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 14.5 M², E NDODHUR NË KATIN E PARË TË BANESAVE SOCIALE, ME NR. PAS. 5/270, ZK 8513, LAGJJA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 5 (PESË) VJET

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.197, datë 10.07.2014, që bën fjalë për kalimin e sip.2.233 m² për ndërtimin e apartamenteve sociale, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kërkesës së Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, që mban datën 19.01.2024, nr. 1001 prot., datë 19.01.2024, e protokolluar në Bashki me nr. 1001 prot., datë 19.01.2024, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :



1. Miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshtim, Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, të ambjentit me sipërfaqe të përgjithshme 169.5 m², ku sipërfaqe ndërtimi 155 m² dhe sipërfaqe funksionale 14.5 m², e ndodhur në katin e parë të banesave sociale, me nr. pas. 5/270, ZK 8513, lagjja nr. 17, rruga “Dalip Peza”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 5 (pesë) vjet, për t’u përdorur: “Për shërbime dhe mbështetje sociale e kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore; për nisma në mbështetje të shërbimeve publike, arsimit, edukimit,

punësimin e zhvillimit ekonomik dhe për informimin, ndërgjegjësimin, integrimin, bashkëjetesën komunitare dhe dialogun social”, sipas genplanit dhe tekstit të kontratës së huapërdorjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.03.2024




Planvendosja dhe planimetria e siperfaqeve te destinuar per huaperdorje

NJESI SHERBIMI

513 Nr.Pas. 5/270 Indeksi i Hartes DR-I-7, J-7

Adresa e Pasurise L.17, rr Dalip Peza, Durrës
endosja e Ambientit


SHK 1 : 1000



Planimetria e katit te pare (BANESAT SOCIALE)

dhe siperfaqe e destinuar per huaperdorje

SHK 1 : 100



MIRATOHET DREKTOR I DREJTORISE LIGONJES SEKTORI I PRONAVE
ARI I BASHKISE DURES
EMRIANA SAKO

ELIJO JANI

PRANVERA GAGANI

Ambiente te Banesave Sociale



VEREDHONJA:
DURRES

PROJEKTI:
AMBIENTONIK

FAZA E PROJEKTI:

GRUPI PROJEKTIM:

EMER MEJEMER
Ing. Enli Kaculi-
Ing. Anila Muiha

FIRMA

EMERTIMI / PLETES
Planimetria dhe planvendosja e
gjedhes ekzistuese

DATA 28.11.2021

SHKALLA 1:200

NO. PLETES

A3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETJEVE

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____ . ____ .2024

DRAFT KONTRATË HUAPËRDORJE

NR.....DT.....2024

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR “SOT PËR TË ARDHMEN” TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 169.5 M², KU SIPËRFAQE NDËRTIMI 155 M² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 14.5 M², E NDODHURUR NË KATIN E PARË TË BANESAVE SOCIALE, ME NR. PAS. 5/270, ZK 8513, LAGJIA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 5 (PESË) VJET

Sot më dt. ____ 02.2024, në ambjentet e Bashkisë Durrës, sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 197, datë 10.07.2014, që bën fjalë për kalimin e sip. 2.233 m² për ndërtimin e apartamenteve sociale, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. ____, datë __.02.2024, “Për dhënie në përdorim, pa kundërsHPërblim, Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen”, të ambjentit me sipërfaqe të përgjithshme 169.5 m², ku sipërfaqe ndërtimi 155 m² dhe sipërfaqe funksionale 14.5 m², e ndodhurur në katin e parë të banesave sociale, me nr. pas. 5/270, ZK 8513, lagjia nr. 17, rruga “Dalip Peza”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 5 (pesë) vjet, nenit 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Bashkia Durrës, së bashku me huamarrësin, bien dakort të hartojnë këtë kontratë huapërdorje me kushtet si më poshtë:

Huadhënës: Bashkia Durrës, përfaqësuar nga kryetar znj. Emiriana Sako.

Huamarrës: Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, me numër identifikimi (NIPT) L32221751H, përfaqësuar nga drejtore ekzekutive znj. Fabiola Laço, e datëlindjes 12.04.1963, lindur në Tiranë, me adresë 1022, Selitë “Medar Shtylla”, me kartë identiteti Nr. 029497906, me numër Cel.0694094622.



DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 OBJEKTI

1.1 Objekti i kësaj kontrate huapërdorje është dhënia në gëzim të përkohshëm të ambjentit me sipërfaqe të përgjithshme 169.5 m², ku sipërfaqe ndërtimi 155 m² dhe sipërfaqe funksionale 14.5 m², e ndodhur në katin e parë të banesave sociale, me nr. pas. 5/270, ZK 8513, lagjia nr. 17, rruga “Dalip peza”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 5 (pesë) vjet, sipas genplanit bashkëlidhur dhe është pjesë e kontrates.

Neni 2 DESTINACIONI

2.1 Qëllimi i përdorimit të ambjentit, objekt i kontratës së huapërdorjes, është për t’u përdorur për shërbime dhe mbështetje sociale e kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore; për nisma në mbështetje të shërbimeve publike, arsimit, edukimit, punësimit e zhvillimit ekonomik dhe për informimin, ndërgjegjësimin, integrimin, bashkëjetesën komunitare dhe dialogun social.

Neni 3 DETYRIMET E HUAMARRËSIT

- 3.1 Huamarrësi është i detyruar të përdorë ambjentet me afat kohor 5 (pesë) vjeçar.
- 3.2 Huamarrësi është i detyruar të hartojë çdo 6 (gjashtë) muaj Akt Monitorime me strukturën e Bashkisë, për destinacionin e përdorimit të ambjentit objekt i kontratës së huapërdorjes, rezultatet e arritura nga projektet e marra përsipër, duke e shoqëruar me dokumentacionin ligjor dhe financiar.
- 3.3 Huamarrësi është i detyruar të ruajë ambjentin me përkujdesje normale sikur të ishte pronë e tij.
- 3.4 Huamarrësi me mbarimin e afatit duhet t’i kthejë ambjentet e marrë në gëzim të përkohshëm në gjendjen sipas përshkrimit të procesverbalit të dorëzimit.
- 3.5 Huamarrësi duhet t’i përdorë ambjentet sipas destinacionit për të cilën i është dhënë në përdorim.
- 3.6 Huamarrësi nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur sendin.
- 3.7 Huamarrësi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme të sendit të dhënë me huapërdorje.
- 3.8 Huamarrësit nuk i lejohet që në pronën e dhënë me huapërdorje t’a japë me nënpërdorje ose t’ja kalojë kontratën një tjetri.
- 3.9 Në ngarkim të huamarrësit janë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve si tatim taksa, ujësjellës kanalizime, furnizimit me energji elektrike, etj.

Neni 4 DETYRIMET E HUADHËNËSIT

- 4.1 Huadhënësi duhet të sigurojë posedimin e qetë të sendit.
- 4.2 Huadhënësi duhet t’a garantojë huamarrësin për pretendimet që mund të kenë të tretët ndaj sendit objekt kontrate.

- 4.3 Huadhënësi dorëzon me procesverbal ambjentin e dhënë pa shpërblim në kohën e caktuar në këtë kontratë.
- 4.4 Huadhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e huamarrësit.
- 4.5 Huadhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur huamarrësi shkel detyrimet, duke e njoftuar këtë të fundit 15 ditë përpara me shkrim.

Neni 5

ZGJIDHJA DHE MBARIMI I HUAPËRDORJES

Huapërdorja mund të zgjidhet me kërkesën e huadhënësit edhe para mbarimit të afatit në këto raste:

- 5.1 Kur huamarrësi nuk e përdor ambjentin sipas destinacionit dhe qëllimit të kontratës.
- 5.2 Kur huamarrësi e keqpërdor, e dëmton dhe nuk kujdeset për ruajtjen e sendit.
- 5.3 Kur huadhënësit i duhet ambjentit për interes publik.
- 5.4 Kur huamarrësi ja kalon sendin një personi të tretë, pa pëlqimin e huadhënësit.
- 5.5 Në rast se huamarrësi nuk e dorëzon vullnetarisht objektin brenda afatit të caktuar, huadhënësit i lind e drejta e lirit të dy ambjenteve.

Kjo kontratë huapërdorje u hartua në 4 (katër) kopje, dy prej të cilave i mban huamarrësi, dy huadhënësi.

HUAMARRËSI
DREJTORE EKZEKUTIVE E QZHK
“SOT PËR TË ARDHMEN”

Fabiola Laço

HUADHËNËSI
BASHKIA DURRËS
KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 Prot.
10

Durrës, më 18.03.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.24 datë 06.03.2024 “Për dhënien në përdorim, pa kundërshtim, Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen”, të ambientit me sipërfaqe të përgjithshme 169.5 m², ku sipërfaqe ndërtimi 155 m² dhe sipërfaqe funksionale 14.5 m², e ndodhur në katin e parë të banesave sociale, me nr. pas. 5/270, zk 8513, lagjja nr. 17, rruga “Dalip Peza”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 5 (pesë) vjet”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

